

V E N D I M
Nr.15 datë 11.1.1993

PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMIT TË NAFTËS DHE TË DISA NËNPRODUKTEVE TË SAJ

Me propozimin e Ministrisë së Financave e të Ekonomisë dhe të Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Çmimi i shitjes me shumicë të naftës bruto caktohet 4500 lekë për ton. Çmimi i shitjes me shumicë i gazit natyror dhe shoqërues caktohet 3000 lekë për 1000 m³.

2. Çmimet e reja të shitjes me pakicë të nënprodukteve të naftës caktohen sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

3. Pikat 1 dhe 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.411, datë 15.9.1992 "Për disa ndryshime në çmimet e nënprodukteve të naftës" shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi më 16 janar 1993.

ZV.KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Kopliku